

## **Enkeleda Pano (Fejzulla) - Keshilltare**

Mban pozicionin e Këshilltarit të Kabinetit të Ministrisë të Drejtësisë që nga muaji dhjetor 2021. Znj. Pano është e diplomuar në degën Psikologji Klinike pranë Fakultetit të Shkencave Sociale, ku në vazhdim ka mbrojtur gradën Doktor i Shkencave, po pranë Fakultetit të Shkencave Sociale, Universiteti i Tiranës. Ka kryer kualifikime të shumta brenda dhe jashtë vendit në fushën e shërbimeve sociale, drejtësisë për të mitur, birësimeve, ekonomisë sociale, ndërmjetësimit, marrëdhënieve me jashtë dhe të komunikimit. Ka botuar publikime si autore e parë në revista prestigjioze kombëtare dhe ndërkombëtare.

Zonja Pano ka një eksperiencë të pasur profesionale mbi 15 vjeçare, fillimisht si nëpunëse pranë Ministrisë së Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, ka qënë lektore e jashtme pranë Fakultetit të Shkencave Sociale, Departamenti i Psikologjisë dhe Pedagogjisë, koordinatore projektesh në organizatën ndërkombëtare Gallup Europe, nëpunëse civile pranë Bashkisë së Tiranës dhe institucionit të Kuvendit të Shqipërisë.

**Fushe e angazhimit:** Drejtësi për të mitur; Birësimet; Marrëdhëniet me Jashtë